


Buletini Informative QERSHOR 2013



Shoqata e Grave Profesioniste
Afariste dhe Zejtare



Poezi per femije nga Angela Chieu

Aktivitetet Qershor 2013

Data	Vendi	Aktiviteti	Pjesemarrja
1-30	Tirane	Panair City park cdo fundjave	4
3	Tirane	Takim me berthamen e parukiereve	7
4	Tirane	Takim me fondacionin Italian	2
9 - 12	Budva	Projekti i grave sipermarrese GTF	2
10	Tirane	Ekspozite 1 ditore tek Hotel Europa me punime Artizanale	3
13	Tirane	Te drejtat e pronesis intelektuale	4
14	Tirane	Panair “Dita e Hapjes se Turizmit ne Velipoje ”	4
17	Tirane	Panair artizanal - Dita e Liqenit ne Shiroke	4
18	Tirane	Takim me berthamen e Mobiljereve	10
19	Tirane	Takim me berthamen e Hoteliereve	10
	Kruje	Takim prezantues me artizanet ne Kruje	3
25	Tirane	Takim me berthamen e parukiereve	8
29-30	Shkup	Panair artizanal	3

Numri i takimeve qe organizohen nga te tjeret - 5

Numri i takimeve qe organizohet nga SHGPAZ - 8

Numri i pjesemarrjesve – 64 persona

Aktivitetet me foto



Takim me perfaqese te ondacionit Italian



Takim me berthamen e parukiereve



Takimi “Nevojat dhe Sfidat e Femres Shqiptare si Sipërmarrëse dhe Menaxhere”



Takim me berthamen e hoteliereve



Takim me berthamen e mobilereve



Takim me artizanet e Krujes



Takim me berthamen e hoteliereve



Takimi me berthamen e parukiereve

PËRFITIMET NGA DEGA E SIGURIMIT TË AKSIDENTEVE NË PUNË

SËMUNDJEVE PROFESIONALE

I siguruari që për shkak të aksidentit në punë ose sëmundjes profesionale, humbet aftësinë për punë, do të përfitojë:

- A. Të ardhura për paaftësi të përkohëshme nga aksidenti në punë, apo sëmundja profesionale.
- B. Të ardhura për invaliditet të përhershëm nga aksidenti në punë, apo sëmundja profesionale.
- C. Të ardhura për invaliditet të pjesshëm të përhershëm nga aksidenti në punë, apo sëmundja profesionale.
- D. Të ardhura për paaftësi të përhershme në masë të vogël, nga aksidenti në punë apo sëmundja profesionale.

2. Kushtet e përfitimit:

- a) Pagesë për paaftësi të përkohëshme nga aksidenti në punë ose sëmundjet profesionale, përfitojnë vetëm të punësuarit;
- b) Ky raport jepet nga Spitali ose KML, deri në 12 muaj.

3. Dokumentacioni:

- a) Raportet mjekësore për aksident në punë;
- b) b) Proces-verbali tip i aksidentit në punë, i cili plotësohet nga subjekti dhe konfirmohet nga Inspektoriati Shtetëror i Punës;c) Formulari i bazës së vlerësuar të tri viteve të fundit të punës. (Ky dokument plotësohet nga sektori i financës së subjektit);
- d) Sektori i financës së subjektit, mbështetur në dokumentat e pikës “a”, plotëson formularin tip-Listëpagesë të përfitimeve afatshkurtëra dhe e dërgon atë në ALSSH, ku ka aktivitetin subjekti;
- e) ALSSH, pasi kontrollon dhe verifikon dokumentat, i kalon pagesat në llogarinë personale bankare të përfituesit, ose në atë të subjektit.

Si të dalloni një gënjeshtar në biznes ?

Gënjeshttrat, të vështira për t'u zbuluar, por të lehta për t'u thënë, kanë tërhequr vëmendjen e shkencëtarëve në studimin më të fundit

Studimi

Shumica e njerëzve të paktën përpiqen të jenë të ndershëm, por në fund të gjithë gënjejnë për ndonjë gjë sado të vogël.

Ne u themi njerëzve që duken shumë bukur, kur nuk fakt e vërteta nuk është kështu. Ne i zbukurojmë disa detaje, kur duam të japim ndonjë lajm të keq. Ne i justifikojmë këto mashtrime të vogla duke e bindur veten se askush nuk do të lëndohet prej tyre.

Disa gënjeshttra janë shumë më të mëdha dhe më të dëmshme, si ato të viteve të fundit, që çuan në epideminë e hipotekave të këqija dhe në kolapsin e tregjeve të banesave dhe atyre financiare.

Mungesa e ndershmërisë dhe e besimit janë bërë aq të përhapura sa shkencëtarët kanë filluar kërkimet për të zbuluar përse njerëzit gënjejnë dhe si t' i dalloni gënjeshttrat.

Një studim i ri prej kërkuesve të Universitetit të Uisconsin Madison dhe Harvard Business School, nënvijëzojnë ndryshimin midis dy llojeve të gënjeshtarëve: ata tradicionalë, të cilët thonë gjëra të pavërteta; dhe mashtruesit në mosveprim, të cilët qëllimisht nuk zbulojnë informata që mund të erësojnë temën që po bisedojnë.

Dhe prej këtyre të dhënave rezulton se gënjeshtarët e drejtpërdrejtë janë më efektivë në mashtrim. Hulumtuesit Lyn M. Van Suol dhe Michael T. Braun të Uisconsin dhe Deepak Malhotra Harvardit, sajuan një seri transaksionesh te 104 subjekte të testuara, një pjesë duke e gënjyer dhe pjesën tjetër duke i thënë të vërtetën.

Ata gjithashtu vëzhguan me kujdes sjelljen e pjesëmarrësve, për të gjetur në mënyrën e tyre të veprimit ndonjë detaj, që tregonte për kuptimin e vërtetës apo gënjeshtreve.



Pse nuk duhet të punoni më shumë se sa duhet ?

Në një kohë kur ekziston kriza për punë, ekziston edhe kriza nga puna. Nuk janë të paktë ata njerëz të cilët bëhen “qen” të punës, duke harruar gjithçka tjetër përveç profesionit. Kjo padyshim që është një e keqe me dëme të mëdha. Ne po ju sugjerojmë nëntë këshilla se si të përmirësoheni për t’i kushtuar kohë jo vetëm punës, por edhe jetës private.

Stili i jetesës

Të punosh shumë, bën keq... ja nëntë këshilla për t’u përmirësuar

Nuk ka asgjë më të keqe sesa të varesh në të gjitha aspektet nga puna. Të jesh gjatë gjithë kohës duke folur në telefon, duke shkruar në tabelë apo në postën elektronike, ta kesh mendjen te pjesa se çfarë duhet të bësh nesër, te klientët që do t’i fitosh me çdo kusht...Qen i punës!? Ndoshta do të ishte më e saktë të thoshim maniak apo siç thonë anglosaksonët “qen i punës”: fjalë për fjalë të dehur pas punës. Një varësi që mund të kthehet edhe në patologjike. Pra një sëmundje me të gjitha efektet e saj, e cila duhet kuruar për të evituar pasojat më të këqija, si: stresin, depresionin, dhimbjen fizike, tensionin e lartë, ulcerën dhe në rastin më të keq, goditjen në tru. Në Itali janë rreth një milion të sëmurët pas punës, me simptoma shumë të veçanta dhe të identifikueshme: nxitim të vazhdueshëm, listë të pafundme angazhimesh, axhendë të mbushur me kolegë sesa miq, e-maile edhe në orët e vona, 40 orë punë gjatë gjithë javës, për të mos thënë edhe më shumë. Në këtë mënyrë arrihet në një stad në të cilin nuk ekziston më jeta private, por vetëm ajo profesionale, me efekte mbi shëndetin, si insomnia, dhimbja kronike e kokës, seksualiteti i dobët dhe varësi të reja (ushqimi, alkooli, paratë). Çfarë duhet bërë për të dalë nga kjo gjendje?



Don Serratt, një guru (këshilltar shpirtëror) i jetës së biznesit këshillon nëntë mënyra për të përballuar problemin e superpunës dhe për të rikuperuar vetveten, në një dimension më të mirë dhe më privat:

Fito për të jetuar, mos jeto për të fituar

Paraja në jetë nuk është gjithçka, ju duhet t’i jepni vlerë jetës tuaj dhe aspekteve të ndryshme që e përbëjnë atë. Fiksimi te “Përeandia e parave” shkatërron ekzistencën, duke e kthyer njeriun të stresuar dhe të zemëruar.

Mos punoni asnjëherë të dielën

Trupi dhe mendja kanë nevojë për pushim, pas një jave stresante. Puna duhet bërë mirë, por për të arritur objektivat duhet të rikuperoni energjitë fizike dhe mendore. Fundjavën, ose të paktën të dielën, ju duhet ta rezervoni për hobet tuaja, miqtë, për personat më të dashur ose për veten tuaj.

Amnistia : Falja e detyrimeve doganore dhe tatimore

Miratohet shtyrja e faljes fiskale deri me 31 dhjetor të këtij viti. Detyrimet tatimore dhe doganore të bizneseve që operojnë në vend do të falen sipas një skemë të miratuar nga Ministria e Financave, e cila fillimisht është miratuar në vitin 2011, por nuk dha rezultatet e pritshme. Në listën e përfituesve janë edhe individët që nuk kanë deklaruar kapitalet, si dhe të vetëpunësuarit që nuk kanë shlyer detyrimet për sigurimet shoqërore. Këtu hyjnë edhe ata që punojnë ose kanë punuar në bujqësi. Sipas ligjit “ Për legalizimin e kapitalit, dhënien e amnistisë për disa vepra penale dhe faljen e një pjesë të borxhit tatimor dhe doganor ” do të përfitojnë operatorët ekonomikë që rivlerësojnë asetet.

Falja e gjobave

Në qendër të amnistisë është falja e gjobave dhe borxheve doganore e tatimore. Sipas ligjit do të bëhen zero taksat, gjobat, apo borxhet në tatime e dogana deri më datë 31 dhjetor 2007, por për borxhet e reja, do të vendoset një taksë progresive. Për vitin 2008, biznesi do të paguajë vetëm 30 për qind të detyrimeve, dhe i falen gjobat e kamatat. Për vitin 2009 do të paguajë 40 për qind të detyrimeve, ndërsa për vitin 2010, 50 për qind të detyrimeve. Pikërisht për këtë vit, ka shumë debate, pasi bilanci i vitit 2010 dorëzohet deri më 31 mars të vitit 2011. Në këtë mënyrë, ka shumë mundësi që biznesi të fillojë të lëvizë në zonën gri të bilancit për të përgjysmuar detyrimet. Nga ana tjetër, fitimet e këtij biznesi janë edhe më të mëdhatë nga shmangia e taksave. Për këtë arsye, në amnistinë fiskale taksa e legalizimit është 6 për qind. Nëse deri dje një kompani ka punuar me një bilanc joreal, vetëdeklarimi i bilancit të rregullt do të kërkojë vetëm 6 për qind të shumës që pretendohet të legalizohet. Pra, në rast se një biznes ka krijuar fitime më shumë se sa thotë bilanci, atëherë tatimi i fitimit të fshehur do të jetë 6%. Biznesi i madh mund të rivlerësojë gjithashtu edhe asetet. Për pronat e patundshme, mendohet se rivlerësimi do të kushtojë 6%, ndërsa për makineritë apo mjetet që amortizohen, do të jetë 7 për qind.

Individët

Për të gjitha pasuritë e individëve që shiten në treg dhe që kanë diferenca midis çmimit të blerjes në momentin fillestar dhe atij të shitjes në tregun aktual, mbi këtë shumë paguhet 10 %. Më konkretisht nëse një apartament i blerë në vitin 2002, kushtonte 30 mijë USD dhe nëse shitet sot kushton 100,000 Euro, ka një diferencë në vlerë prej rreth 100,000 USD, c’ ka do të bënte që tatimi në masën 10% të ishte 10,000 USD. deri në 31 dhjetor të këtij viti duke bërë rivlerësimin qytetari do të paguajë vetëm 1,000 USD. Sipas statistikave deri në vitin 2011 janë rivlerësuar banesa në një shumë prej 700 milionë dollarësh, prej të cilave kanë përfituar mbi 14 mijë familje.

Falen kamatëvonesat për sigurimet shoqërore

Të gjithë të vetëpunësuarve u falen sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, gjobat dhe kamatëvonesat e papaguara deri më 31 dhjetor 2008. Falen edhe 2 vitet e fundit nëse paguajnë sigurimet për vitin 2011. Kësaj kategorie, nëse dëshiron të paguajë detyrimet për kontributet, i falen gjobat dhe kamatëvonesat për të gjithë periudhën e kaluar. Personave fizikë, biznes i vogël, u falen gjobat dhe kamatëvonesat për të punësuarit e tyre, deri më 31 dhjetor 2010.

Borxhet e qytetarëve që falen

Të gjitha taksat e papaguara nga qytetarët deri në fund të vitit 2010 falen.

Të gjitha taksat e papaguara për automjetet si dhe gjobat e vendosura ndaj tyre deri në 2010, falen.

Detyrimet doganore të makinave të importuara deri në fund të vitit 2010, falen 50% e principalit të detyrimit si dhe gjobat e interesat nëse paguhet 50% e principalit të detyrimit.

Amnistia : Falja e detyrimeve doganore dhe tatimore

Biznesi i vogël

1. Përfiton të drejtën të legalizojë çdo shumë monetare të padeklaruar kundrejt pagimit të tarifës prej 3 për qind.
2. Të vetëpunësuarve në bujqësi u falen kontributet e papaguara të sigurimeve shoqërore e shëndetësore deri në fund të vitit 2008. Atyre u falen kontributet e papaguara për vitet 2009-2010 me kusht që të paguajnë detyrimet e vitit 2011 brenda afatit ligjor.
3. Të gjithë tatimpaguesve të tjerë që nuk kanë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për të punësuarit e tyre për periudhën deri më 31 dhjetor 2010, u falen gjobot dhe kamatëvonesat që lidhen me këto detyrime.
4. Të gjithë tatimpaguesve u falen gjobot e papaguara për mosinstalimin e pajisjeve fiskale me kusht që t' i kenë të instaluara ato brenda datës 28 shkurt 2011.

Biznesi i madh

1. Të gjithë personave juridikë, të regjistruar si subjekt i TVSH-së, u falen detyrimet tatimore të papaguara deri më 31 dhjetor 2008. Detyrimet për vitin 2009 u falen nëse paguajnë 30 për qind të principalit, ndërsa për vitin 2010 u falen nëse paguajnë 50 për qind të principalit.
2. Personat juridikë kanë të drejtën në rivlerësojnë me vlerën e tregut pasuritë e paluajtshme dhe makineritë kundrejt tarifave 5 për qind dhe 3 për qind.
3. Diferenca që rezulton nga rivlerësimi do të përfshihet në shpenzimet vjetore në formën e amortizimit.

Legalizimi i parave

Në datën 15 shtator 2011, një individ ka hapur një llogari në bankë në shumën 1 000 000 lekë për legalizim, në bazë të ligjit nr. 10418, datë 21.4.2011. Për efekt legalizimi, banka ka mbajtur si tatim në burim 3% të shumës, pra 30 000 lekë.

Në rast se në datën 20 qershor 2012, ky individ paraqitet pranë bankës për të bërë transferim në një llogari bankare në Itali të shumës prej 500 000 lekësh, në këtë rast, për të proceduar me transferimin, banka i mban 13% të shumës që kërkohet të transferohet, pra 65 000 lekë.



Redaktim&pergatije perfundimtare
msc.Flutura XHABIJA

Mblodhi materialet & draftoi

Jur,Marjeta MAZNIKU

Ndihmoi, Silvana Barci

Ndihmuan me verejtje shume bashkepunetore te jashtem